



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY
"ISA BOLETINI"
MITROVICË**

Nr. Prot. 2706 Dt. 03.11.2022

Në bazë të vendimit të Këshillit Drejtues nr. prot. 2702 të datës 02.11.2022, Universiteti "Isa Boletini", i Mitrovicës shpall:

KONKURS

Për ndarjen e bursave universitare për studentët e studimeve themelore (bachelor) dhe studimet master të Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë, për vitin akademik 2021/2022.

I. Bursa universitare iu ndahet studentëve të studimeve bachelor dhe studimeve master.

Të drejtë aplikimi për bursë universitare kanë studentët, të cilët i plotësojnë këto kushte:

1. të jenë student të rregullt të Universitetit të Mitrovicës;
2. të jenë student të vitit të dytë e më lart;
3. të mos kenë vit të përsëritur të studimeve;
4. të kenë dhënë të gjitha provimet e vitit paraprak përkatës të studimeve në afatin e shtatorit;
5. të kenë notë mesatare të studimeve më së paku:
 - 8.0 (tetë pikë zero) — për studentët e studimeve bachelor në Fakultetin e Gjeoshkencave, Fakultetin e Teknologjisë Ushqimore dhe Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike;
 - 9.00 (nëntë pikë zero) — për studentët e studimeve bachelor në Fakultetin Juridik, Ekonomik dhe të Edukimit;
 - 8.5 (tetë pikë pesë) — për studentët e studimeve master në Fakultetin e Gjeoshkencave; Fakultetin e Teknologjisë Ushqimore dhe Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike;
 - 9.00 (nëntë pikë zero) — për studentët e studimeve master në Fakultetin Juridik, Ekonomik dhe të Edukimit.

II. Studentët që i plotësojnë kushtet nga pika I e këtij vendimi duhet t'i paraqesin këto dokumente:

- Dëshminë e aplikimit për bursë në SMU
- Vërtetimi për statusin e studentit (lëshohet nga Fakulteti)
- Pasqyra e notave (lëshohet nga Fakulteti)
- Deklarata nën betim e nënshkruar.

III. Shuma e mjeteve që do të ndahet për bursa universitare caktohet me vendim të veçantë të Këshillit Drejtues.

Studentët bursistë do ta gëzojnë këtë të drejtë për vitin akademik 2021/2022.

Afati i aplikimit zgjat prej datës 04.11.2022 deri më 10.11.2022.

Dorëzimi i dokumentacionit bëhet në fakultetet përkatëse.

**Shkarkoni Fletëparaqitjen nga raporti i aplikimit në SMU
Shkarkoni deklaratën në betim**

